

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës : **PAKR 271/13**

Më: **30 janar 2014**

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS me kolegjin e përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati, në cilësinë e Kryetares së kolegjit dhe gjyqtares raportuese, gjyqtari i EULEX-it Timo Voujolahti dhe gjyqtari Rasim Rasimi si anëtarë të kolegjit, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore të EULEX-it si proces-mbajtëse, Anna Malmstrom, në lëndën penale kundër:

E.K dhe **S.B**, të liruar nga akuza në shkallë të parë për veprën penale të **Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile**, sipas Neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), tani vepër e dënueshme sipas Neneve 31 dhe 153, paragrafët 2.1 dhe 2.14, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), lidhur me Nenin 3 të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 (Neni 3), dhe Nenin 13.2 të Protokollit Shtesë II të 8 qershorit 1977, të Konventave të Gjenevës të vitit 1949 (Protokolli Shtesë II).

M.H.1, **M.H.2**, **N.H**, **N.B** dhe **J.K**, që të gjithë të liruar nga akuza në shkallë të parë për veprat penale të **Dhënies së Ndhmës Kryerësve pas Kryerjes së Veprës Penale**, në pajtim me Nenin 305 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës 2004, tani vepër e dënueshme sipas Nenit 388 (1) dhe (2) të KPRK-së.

duke vepruar lidhur me Ankesën e Prokurorit Special të Republikës së Kosovës, e paraqitur më 28 maj 2013 kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prizrenit, nr. P 249/12, të datës 1 shkurt 2013;

pasi mori parasysh përgjigjet në ankesë të Mbrojtësve Osman Zajmi për **M.H.1** dhe Brahim Sopa për **M.H.2**, që të dyja të paraqitura më 4 qershor 2013, si dhe të Mbrojtësit Hajrip Krasniqi për **N.H**, e paraqitur më 5 qershor 2013;

po ashtu, pasi mori parasysh Përgjigjen e Prokurores së Apelit nga Zyra e Prokurorit të Shtetit, nr. PPA/I.-KTZ 236/12, të datës 26 gusht 2013, dhe të paraqitur në të njëjtën ditë;

pasi mbajti seancën e hapur më 30 janar 2014 me të gjitha palët e thirrura me rregull, në praninë e të pandehurve **E.K** dhe **S.B**, Prokurorit të Shtetit Claudio Pala, palës së dëmtuar **D.B** dhe përfaqësuesit të saj ligjor Vladimir Mojsiloviq;

pas këshillimit dhe votimit më 30 janar 2014,

në pajtim me Nenin 240 dhe në vazhdim të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK)

nxjerr këtë:

AKTGJYKIM

- I. Me të cilin pranohet Ankesa e Prokurorit Special, e parashtruar më 28 maj 2013 kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prizrenit, nr. P 249/121, të datës 1 shkurt 2013.
- II. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prizrenit Nr. P 249/13, i datës 29.03.2012, NDRYSHOHET me dispozitivin si në vijim:

I akuzuari **E.K**, i lindur më XX 19XX në (), djali i K, shtetas i Kosovës, me banim në , ka kryer shkollën e mesme, në paraburgim nga 14 dhjetori 2010 deri më 2 gusht 2011, dhe

I akuzuari **S.B**, i lindur më XX 19XX në fshatin (), djali i M, shtetas i Kosovës, me banim në rrugën , në paraburgim qysh nga 18 prilli 2012 deri më 1 shkurt 2013;

shpallen

FAJTORË

sepse në natën e 17 korrikut dhe orët e para të mëngjesit të 18 korrikut 1998, në cilësinë e anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe në bashkë-kryerje me ushtarë të tjerë deri tani të pidentifikuar të UÇK-së, zbatuan masa të frikësimit dhe terrorit kundër popullatës civile serbe të , duke marrë pjese në një sulm të armatosur të qëllimshëm kundër familjeve serbe të fshatit në fjalë. Sulmi u krye duke shtënë me armë zjarri për disa orë gjatë natës, kundër shtëpisë së familjes **B**, ku ishin mbledhur rreth 15 banorë serbë.

Për këtë arsye, të akuzuarit **E.K** dhe **S.B** kryen në bashkë-kryerje veprën penale të **Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile**, sipas Neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ) tani vepër e dënueshme sipas Neneve 31 dhe 153, paragrafët 2.1 dhe 2.14 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës lidhur me Nenin 3 të përbashkët të katër Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949, dhe Nenin 13.2 të Protokollit Shtesë II të 8 qershorit 1977, të Konventave të Gjenevës të vitit 1949.

Të akuzuarit **E.K** dhe **S.B** që të dy **dënohen** me nga pesë (5) vite burgim, në pajtim me Nenin 38 paragrafi 1 dhe Nenin 142 të KPRSFJ-së.

Koha e kaluar në paraburgim, nga 14 dhjetori 2010 deri më 2 gusht 2011, nga **E.K**, dhe nga 18 prilli 2012 deri më 1 shkurt 2013 nga **S.B**, do të u llogaritet në kohën e dënimit, në pajtim me Nenin 50, paragrafët 1 dhe 3 të KPRSFJ-së.

I akuzuari **M.H.1**, i lindur më XX 19XX në fshatin , djali i H dhe Q, shtetas i Kosovës, me banim në fshatin , ka të kryer shkollën fillore, punon si zdrukthëtar;

i akuzuari **M.H.2**, i lindur më XX 19XX në fshatin , djali i H dhe Q, shtetas i Kosovës, me banim në fshatin , ka të kryer shkollën e mesme, punon si zdrukthëtare;

I akuzuari **N.H**, i lindur më XX 19XX në fshatin , djali i A dhe F, shtetas i Kosovës, me banim në fshatin , ka të kryer shkollën fillore, pronar i një kafeneje;

I akuzuari **N.B**, i lindur më XX 19XX në fshatin , djali i B dhe F, shtetas i Kosovës, me banim në fshatin , ekonomist i diplomuar; dhe

i akuzuari **J.K**, i lindur më XX 19XX në fshatin , djali i M dhe Q, shtetas i Kosovës, me banim në , ;

shpallen

FAJTORË

sepse ata ndihmuan **E.K** (nën hetime për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile) të shmangë zbulimin, duke dhënë deklarata të rreme si dëshmitarë në mbështetje të mbrojtjes me alibi të **E.K**, më konkretisht, kur u dëgjuan në cilësinë e dëshmitarëve nga Zyrtari i Njësisë së EULEX-it për Hetime të Krimeve të Luftës në fshatin më 23 shkurt 2011 (**M.H.1** dhe **M.H.2**), më 3 mars 2011 (**N.H** dhe **N.B**) dhe më 8 mars 2011 (**J.K**), ata deklaruan rrejshëm se **E.K** ishte i plagosur në fillim të korrikut 1998. Në këtë mënyrë ata ndihmuan **E.K** pas kryerjes së veprës penale për të cilën **E.K** u shpall fajtor.

Për këtë arsye, **M.H.1**, **M.H.2**, **N.H**, **N.B** dhe **J.K** kryen veprën penale të **Dhënies së Ndihmës Kryerësve pas Kryerjes së Veprës Penale**, sipas Nenit 305 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës 2004 (KPK), tani vepër e dënueshme sipas Nenit 388 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

M.H.1, **M.H.2**, **N.H**, **N.B** dhe **J.K** që të gjithë **dënohen** me gjashtë (6) muaj burgim, në pajtim me Nenin 36 paragrafi 1, Nenin 38 paragrafët 1 dhe 2 dhe Nenin 305 paragrafi 2 të KPK-së.

Në pajtim me Nenin 41 paragrafi 1, pika 1 dhe Nenin 43 paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së, dënimet jepen me kusht për një periudhë kohore prej një (1) viti.

Të gjithë të dënuarit do të paguajnë veç e veç dhe së bashku shpenzimet e procedurës penale sipas Nenit 102 paragrafi 1 dhe Nenit 105 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) përveç shpenzimeve të përkthimit me gojë e me shkrim, si dhe shpenzimet e kapjes dhe shoqërimit të **E.K** dhe **S.B.** **E.K** dhe **S.B** do të mbulojnë edhe shpenzimet e kapjes dhe shoqërimit të tyre. Një aktvendim ndaras mbi shumën e shpenzimeve do të nxirret nga gjykata kur të sigurohen këto të dhëna, në pajtim me Nenin 100 paragrafi 2 të KPPK-së.

ARSYETIM

I. Historia procedurale e çështjes

1. Më 30 mars 2011, Prokurori Special ngriti aktakuzën PPS nr. 75/2010 tek Gjykata e Qarkut të Prizrenit, kundër të akuzuarve **E.K** dhe **H.M** dhe i ngarkoi ata me veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile në më 17 dhe 18 korrik 1998, dhe kundër të pandehurve **M.H.1**, **M.H.2**, **N.H**, **N.B** dhe **J.K**, për veprën penale të Dhënies së Ndhimës Kryerësve pas Kryerjes së Veprave Penale. Aktakuza u konfirmua me Aktvendimin KA Nr. 76/11 më 29 prill 2011.

2. Shqyrtimi gjyqësor i parë filloi më 28 qershor 2011 para trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe më 2 gusht 2011 trupi gjykues shqiptoi Aktgjykimin P 134/11 ku **E.K** u shpall fajtor dhe u dënua me pesë (5) vite burgim, **H.M** u lirua nga akuza dhe **M.H.1**, **M.H.2**, **N.H**, **N.B** dhe **J.K** u shpallën fajtorë dhe secili prej tyre u dënua me gjashtë (6) muaj burgim me kusht për një periudhë kohore një (1) vjeçare.

3. Më 31 maj 2012, Prokurori Special ngriti Aktakuzën PPS nr. 75/2010 tek Gjykata e Qarkut të Prizrenit kundër **S.B** dhe e ngarkoi atë me veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile. Aktakuza u konfirmua me Aktvendimin KA 97/12 më 30 maj 2012.

4. Më 4 shtator 2012, Gjykata Supreme e Kosovës, duke marrë vendim lidhur me ankesat e Mbrojtësve të **E.K** dhe **N.H**, lëshoi Aktvendimin AP-Kz 20/2012 me të cilin Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prizrenit nr. P 134/11, përveç pjesës që kishte të bënte me lirimin nga akuza të **H.M**, që nuk ishte objekt i ankesave, u anulua dhe lënda iu kthye gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

5. Më 7 nëntor 2012, trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut të Prizrenit mori vendim mbi kërkesën e Prokurorit Special për bashkimin e procedurës penale, dhe lëshoi aktvendim me të cilin bashkoi procedurën penale në çështjen penale kundër **E.K**, **M.H.1**, **M.H.2**, **N.H**, **N.B** dhe **J.K** me procedurën penale në çështjen penale kundër **S.B** nën lëndën nr. P 249/12.

6. Shqyrtimi kryesor filloi në Gjykatën e Qarkut në Prizren më 30 nëntor 2012 dhe përfundoi me 29 janar 2013. Aktgjykimi me të cilin trupi gjykues i shpalli të gjithë të pandehurit të pafajshëm u shpall më 1 shkurt 2013.

7. Më 28 maj 2013, brenda afatit u parashtrua ankesa e Prokurorit Special. Përgjigje në ankesë u parashtruan nga Mbrojtësi Osman Zajmi në emër të **M.H.1**, Mbrojtësi Brahim Sopa në emër të **M.H.2** më 4 qershor 2013 dhe Mbrojtësi Hajrip Krasniqi në emër të **N.H** më 5 qershor 2013. Mendimi i Prokurorit të Apelit u parashtrua më 26 gusht 2013.

II. Parashtrësas e palëve

1. Ankesa e Prokurorit Special

8. Prokurori Special e kundërshtoi Aktgjykimin e Apeluar mbi bazat e vërtetimit të gabuar të situatës faktike. Ai parashtron se e sheh të palogjikshëm arsyetimin e Gjykatës. Gjykata konstatoi si të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se **E.K** dhe **S.B** ishin të pranishëm dhe të armatosur me pushkë në oborrin e shtëpisë serbe në mëngjesin e 18 korrikut 1998 “menjëherë pasi serbet u dorëzuan dhe sulmi kishte përfunduar”. Gjykata gjithashtu pranoi se dëshmitarët thanë se të dy të pandehurit në atë rast kishin të veshura uniforma të UÇK-së. Derisa pa dyshim nuk ka asnjë provë të drejtpërdrejtë nga një dëshmitar okular se **E.K** dhe **S.B** morën pjesë në sulm dhe se çfarë veprimesh morën gjatë të shtënave, pjesëmarrja e tyre në sulm është i vetmi përfundim logjik që rrjedh nga rindërtimi i ngjarjeve nga Gjykata. I vetmi shpjegim i mundshëm mbi praninë e **E.K** dhe **S.B** në oborrin e shtëpisë serbe me ushtarë të tjerë të UÇK-së menjëherë pas përfundimit të sulmit, që të dy të armatosur me pushkë dhe në uniforma të UÇK-së, është se të dy të pandehurit ishin në mes të ushtarëve që morën pjesë në sulm. Shpjegimi tjetër alternativ se ata ishin thjesht kalimtarë të rastit është qartë jo bindës dhe duhet të përjashtohet.

9. Asnjë provë nuk doli nga shqyrtimi gjyqësor në lidhje me atë se çfarë veprimesh konkrete kreu secili prej të akuzuarve gjatë sulmit. Ajo çka dihet është se ata ishin pjesë e njësisë së UÇK-së që kreu sulmin. Një njësi ushtarake funksionon në mënyrë të tillë që në mes të anëtarëve të saj ndahen detyra të ndryshme. Gjithsecili duhet të kontribuojë për qëllimin themelor të veprimit ushtarak (në këtë rast sulmi mbi shtëpinë). Nuk kërkohet të provuarit e saktë të veprimeve të tyre konkrete, për të përcaktuar se ata morën pjesë në sulm dhe së fundi në krim. Prokurori Special kërkon nga Gjykata e Apelit që t'i gjejë **E.K** dhe **S.B** fajtor, ashtu siç edhe janë akuzuar në aktakuzë.

10. Lirimi nga akuza i **M.H.1**, **M.H.2**, **N.H**, **N.B** dhe **J.K** është i lidhur me atë të **E.K**. Prandaj Prokurori Special kërkon nga Gjykata e Apelit, pas pranimit të përgjegjesisë penale të **E.K**, të konfirmojë faktet e përcaktuara nga Gjykata e Qarkut në Prizren dhe t'i dënojë të pesë të akuzuarit.

2. Përgjigjet e mbrojtësve

11. Mbrojtësi Osman Zajmi (për **M.H.1**) dhe Mbrojtësi Brahim Sopa (për **M.H.2**) në përgjigjet e tyre identike parashtrojnë se veprat e pretenduara penale të **M.H.1** dhe **M.H.2** nuk u provuan me ndonjë provë të thelbësore të rëndësishme gjatë shqyrtimit gjyqësor. Asnjëri prej dëshmitarëve

nuk tregoi që **M.H.1** dhe **M.H.2** të kenë qenë kryerës të kësaj vepre penale. Ankesa e Prokurorit Special duhet të hidhet poshtë.

12. Mbrojtësi Hajrip Krasniqi (për N.H) parashtron se termi kryerës i krimit nënkupton personin i cili ka kryer veprën penale kundër të cilit janë kryer procedurat penale. Fajësia për ndihmë mund të konfirmohet atëherë pasi kryerësi të jetë shpallur fajtor nga gjykata. **N.H** nuk mund të shpallej fajtor pasi gjykata e shpalli **E.K** jo fajtor. Situata faktike është vërtetuar drejt, sikur dhe vlerësimi i fakteve dhe besueshmëria e deklaratave të dhëna nga të akuzuarit.

3. Përgjigja e Prokurores së Apelit

13. Në përgjigjen e saj, Prokurorja e Apelit propozon që Gjykata e Apelit të aprovojë ankesën e Prokurorit Special dhe t'i shpallë të pandehurit fajtorë. Ajo parashtron se, megjithëse rigjykimi përfundoi me lirim të të gjithë të akuzuarve nga akuzat, përsëri, pjesë të rëndësishme të arsytimit të Aktgjykimit të shqiptuar nga Gjykata e Qarkut në Prizren ishin kopjuar identikisht në arsyetimin e Aktgjykimit të Ankimuar. Disa pjesë të arsytimit janë kopjuar me disa modifikime. Trupi gjykues i Gjykatës Themelore – ndryshe nga trupi gjykues i mëparshëm – i shmanget identifikimit se sulmi i armatosur kundër civilëve serbë në fakt u krye nga UÇK, dhe gjithashtu se anëtarë të UÇK-së mbushën oborrin pas sulmit në mëngjes. Përfundimisht, Gjykata Themelore duket të nuk e ka parë lidhjen ndërmjet konfliktit të armatosur dhe sjelljes së pretenduar në aktakuzë, pavarësisht se ka prova të mjaftueshme për t'i mbështetur këto gjetje. Kjo e shton vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, siç është paraqitur nga Prokurori Special.

III. Gjetjet e Gjykatës së Apelit

1. Kompetenca e Gjykatës së Apelit

14. Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për të vendosur mbi Ankesat, sipas Nenit 17 dhe Nenit 18 të Ligjit për Gjykatat (Ligji nr. 03/L-199).

15. Kolegji i Gjykatës së Apelit është formuar në pajtim me Nenin 19 paragrafi (1) të Ligjit për Gjykatat, dhe Nenit 3 të Ligjit për Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053).

2. Ligji procedural i zbatueshëm

16. Ligji i procedurës penale i zbatueshëm për çështjen penale në fjalë është Kodi (i vjetër) i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), që ka qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2012.¹ Interpretimi i duhur i dispozitave kalimtare të Kodit (të ri) të Procedurës Penale (KPP), në fuqi që prej 1 janarit 2013, përcakton se procedurat penale të filluara para hyrjes në fuqi të Kodit të ri, për të cilat gjykimi tashmë i filluar, por i papërfunduar me një vendim të formës së prerë, dispozitat e

¹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës ka qenë në fuqi nga 06.04.2004 deri më 31.12.2013 (nën emrin Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës deri më 06.01.2009).

KPPK-së janë të zbatueshme përshtatshmërisht deri sa vendimi të marrë formë të prerë. Referencë në këtë drejtim i bëhet Mendimit Juridik me nr. 56/2013 të Gjykatës Supreme të Kosovës, i miratuar në seancën e saj të përgjithshme në datën 23 janar 2013.

3. Gjetjet lidhur me meritat

3.1. Lënda e E.K dhe e S.B

3.1.1. Gjendja faktike

17. Trupi Gjykues i Gjykatës Themelore të Prizrenit gjeti se faktet si në vijim janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Natën e datës 17 korrik dhe në orët e para të mëngjesit të datës 18 korrik 1998, një grup personash të panjohur sulmuan shtëpinë civile të **D.B** dhe familjen e saj në fshatin (zonë e). Gjatë sulmit, në shtëpi ishin prezent pothuajse të gjithë banorët serbë të fshatit, gjithsej rreth 15 persona. Gjatë sulmit meshkujt serbë hapën zjarr me pushkë dhe pistoleta. Në mëngjesin e datës 18 korrik 1998, familjet serbe e ndalën rezistencën dhe u dorëzuan. Oborri i shtëpisë **B** u mbush me njerëz të panjohur. **E.K** dhe **S.B** ishin të pranishëm në oborr menjëherë pas sulmit. Që të dy ishin të armatosur me pushkë.

18. Trupi gjykues nuk ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se **E.K** dhe **S.B** ishin të pranishëm në mbrëmjen e datës 17 korrik dhe gjatë natës së datës 18 korrik 1998 dhe si pasojë trupi gjykues nuk ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se **E.K** dhe **S.B** kanë marrë pjesë në sulm.

19. Gjykata e Apelit pajtohet me përcaktimin e fakteve të trupit gjykues dhe gjen se ato janë të vërtetuara përtej dyshimit të arsyeshëm. Gjykata e Apelit, megjithatë, nuk pajtohet me konstatimet e trupit gjykues në lidhje me praninë e **E.K** dhe **S.B** dhe, më tej, Gjykata e Apelit nuk pajtohet me konkluzionet e nxjerra nga Trupi Gjykues.

20. E vetmja provë ekzistuese në këtë lëndë për të vërtetuar se çfarë ndodhi gjatë datave 17 dhe 18 korrik 1998, përveç vetë të pandehurve, janë dy dëshmitaret **D.B** dhe **S.B**, të cilat ndodheshin që të dyja në shtëpi gjatë sulmit. Trupi gjykues i gjeti deklaratat e të dy grave të besueshme, por gjeti se ato nuk qenë në gjendje t'i japin gjykatës ndonjë provë në lidhje me atë se kush saktësisht i sulmoi ato.

21. Gjykata e Apelit nuk sheh ndonjë arsye se pse ky vlerësim i bërë nga trupi gjykues duhet të konsiderohet i pasaktë. **D.B** dhe **S.B** i kanë përshkruar ngjarjet në mënyrë të njëjtë në të gjitha deklaratat e ndryshme të dhëna, megjithëse kishte kaluar shumë kohë. Edhe pse ato natyrisht kanë një dëshirë të madhe që t'i shohin kryerësit të ndëshkohen, Gjykata e Apelit nuk sheh ndonjë arsye se pse ato duhet të gënjejnë për atë se çfarë kanë parë apo dëgjuar, dhe deklaratat e tyre nuk duken qëllimisht të ekzagjeruara në ndonjë mënyrë. Ato, në veçanti **D.B**, i kanë përshkruar ngjarjet në detaje.

22. **D.B** ka përshkruar se sulmi filloi rreth orës 1.00 apo 2.00 të mëngjesit të datës 18 korrik 1998. Ky filloi me ikjen e rrymës. Pak pas kësaj, ato dëgjuan që dikush përjashta po thërriste

emrin e burrit të **D.B**, duke i kërkuar atij që të mos dilte jashtë. Personi që po thërriste u identifikua nga **D.B** të ishte **E.K**. Zëri i tij u njoh si nga vetë **D.B**, ashtu dhe nga bashkëshorti i saj. Në atë moment, ato dëgjuan një breshëri mitralozi në drejtim të shtëpisë së tyre. Menjëherë pas kësaj, mbi shtëpinë e tyre filluan të qëllonin edhe të tjerë. Të shtënat vinin nga të gjitha drejtimet dhe ato zgjatën deri në orët e para të mëngjesit të datës 18 korrik 1998. Ndërkohë, një granadë dore shpërtheu diku afër shtëpisë.

23. Si **D.B**, ashtu dhe **S.B** përshkruan praninë e ushtarëve të UÇK-së në fshat përpara sulmit dhe se si oborri i shtëpisë **B** u mbush me ushtarë të UÇK-së menjëherë pas sulmit. Ushtarët ishin të veshur me uniformë dhe mbanin armë. Në mes të ushtarëve, ato të dyja njohën **E.K** dhe **S.B**. Gratë i njihnin **E.K** dhe **S.B** nga fshati, dhe prandaj i identifikuan ata. Edhe **E.K** dhe **S.B** ishin të veshur me uniformë dhe mbanin pushkë. **D.B** dëshmoi më tej mbi praninë e **E.K** përpara sulmit, diçka që ajo e ka konstatuar në të gjitha deklaratat e saj.

24. Trupi gjykues i Gjykatës Themelore i gjeti të besueshme në mënyrë të dyshimtë deklaratat e **E.K** dhe të **S.B**. **E.K** deklaroi se ai nuk ishte aspak i pranishëm në fshat më 17 dhe 18 korrik 1998, dhe se nuk ishte në dijeni të kishte ndodhur ndonjë sulm. Trupi gjykues gjeti se nuk kishte gjasa që ai të mos ishte në dijeni të sulmit. **E.K** gjithashtu deklaroi se ishte në spital kur ndodhi sulmi, pasi që ai ishte plagosur më 11 korrik 1998. Trupi Gjykues e gjeti këtë të pavërtetë, dhe gjeti të provuar se **E.K** u plagos në gusht 1998, pas sulmit. **S.B** gjithashtu deklaroi se ai nuk ishte prezent në fshat më 17 dhe 18 korrik 1998. Trupi gjykues, duke shqyrtuar deklaratat e **D.B** dhe **S.B** dhe, të shikuara së bashku me deklaratat e të pandehurve të tjerë, gjeti se **S.B** nuk ishte i besueshëm.

25. Gjykata e Apelit nuk sheh ndonjë arsye se pse vlerësimi i Trupit Gjykues mbi deklaratat e **E.K** dhe **S.B** të jetë i pasaktë.

26. Bazuar në të gjitha provat dhe veçanërisht në dëshmitë e **D.B** dhe **S.B**, Gjykata e Apelit gjen të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se sulmi mbi shtëpinë e **B** u krye nga UÇK. Gjykata e Apelit më tej gjen të vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se si **E.K**, ashtu dhe **S.B** ishin të pranishëm në oborrin e shtëpisë menjëherë pas sulmit, të veshur me uniformë, duke mbajtur pushkë. Në lidhje me **E.K**, Gjykata e Apelit gjithashtu gjen të provuar se ai ishte prezent jashtë shtëpisë së **B** pak para se të fillonte sulmi.

3.1.2. Elementët e krimeve të luftës

27. Gjykata e Apelit pajtohet plotësisht me gjetjet e trupi gjykues të Gjykatës Themelore në lidhje me vlerësimin e krimeve të luftës.

28. Në përputhje me praktikat juridike të Tribunalit Ndërkombëtar të Krimeve për ish-Jugosllavinë (TNKJ)², siç citohet në Aktgjykimin e ankimuar, Gjykata e Apelit gjen të provuar se në periudhën kohore të sulmit në fshatin e _____ më 17 dhe 18 korrik 1998, në Kosovë ekzistonte një konflikt i brendshëm i armatosur. Neni 3 i Përbashkët i Konventave të Gjenevës dhe Neni 13.2 i Protokollit Shtesë II janë të zbatueshme për konfliktin në Kosovë.

² Lënda IT-04-84, Aktgjykimi i datës 3 prill 2008 dhe Lënda IT-05-87/1-T, Aktgjykimi i datës 23 Shkurt 2011.

29. Gjykata e Apelit gjen të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se sulmi në datën 17 dhe 18 korrik 1998 u drejtua kundër popullatës civile serbe të fshatit . Shtëpia që u sulmua ishte me civilë serbë; asnjë nga personat nuk kishte ndonjë status tjetër përveç atij të civilit. Serbët që ishin mbledhur në shtëpi kishin qasje në armë dhe ato u përdorën gjatë sulmit. Gjykata e Apelit nuk ka gjetur ndonjë arsye për të dyshuar se këto armë nuk u përdorën për ndonjë gjë tjetër përveç vetëmbrojtjes.

30. Kështu që Gjykata e Apelit gjen të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të gjithë serbët e mbledhur në shtëpinë e sulmuar më 17 dhe 18 korrik 1998 ishin civilë që nuk po merrnin pjesë në luftimet ndërmjet forcave të UÇK-së dhe Ushtrisë Jugosllave (serbe) që ndodhi nga prilli 1998 deri në mes të korrikut 1999. Prandaj, ata ishin nën status të mbrojtur si civilë, që garantohet nga Neni 3 i Përbashkët dhe Neni 13.2 i Protokollit Shtesë II.

31. Gjykata e Apelit gjen se sulmi mbi popullatën serbe në më 17 dhe 18 korrik 1998 ishte në kundërshtim me Nenin 3 të Përbashkët dhe Nenin 13.2 të Protokollit Shtesë II, dhe me të gjitha rregullat e së drejtës ndërkombëtare në fuqi gjatë konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë. Sulmi gjithashtu përbën një sulm të armatosur mbi popullatën civile, që ndalohej dhe dënohet nga Neni 22 dhe 142 i KP të RFSJ-së, aktualisht veprë e dënueshme nga nenet 31 dhe 153 paragrafi 2.1 dhe 2.14 të KPRK-së.

3.1.3. Vlerësimi ligjor i gjendjes faktike

32. Siç u përmend më lart, Gjykata e Apelit nuk pajtohet me konkluzionet e nxjerra nga Trupi Gjykues i Gjykatës Themelore për faktet e konstatuara.

33. Gjykata e Apelit ka gjetur të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se **E.K** dhe **S.B** ishin prezent në oborrin e familjes **B** menjëherë pas sulmit, të veshur me uniformë dhe të armatosur me pushkë. Në lidhje me **E.K**, Gjykata e Apelit gjithashtu ka gjetur të provuar se ai ishte prezent përpara shtëpisë së familjes **B** pak më përpara sulmit. Megjithatë, ky është vetëm një argument shtesë. Gjykata e Apelit ka gjetur gjithashtu të provuar se sulmi u krye nga një grup i UÇK-së. Nga provat e paraqitura, nuk është bërë e mundur të vërtetohet saktësisht se çfarë ndodhi gjatë sulmit, dhe se çfarë bënë konkretisht dhe individualisht personat që morën pjesë në të. Përveç pranisë së **E.K** përpara sulmit, e njëjta u vërtetua edhe nga trupi gjykues i Gjykatës Themelore. Konkluzionet e nxjerra nga kjo nga trupi gjykues ishte që nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se **E.K** dhe **S.B** morën pjesë në sulm.

34. Prokurori Special ka argumentuar se nuk kërkohet prova ekzakte e veprimeve specifike të të pandehurve për të vërtetuar se ata kanë marrë pjesë në sulm. Ajo që dihet është se ata ishin pjesë e grupit të UÇK-së që filloi dhe kreu sulmin. Gjykata e Apelit pajtohet me argumentet e Prokurorit Special.

35. Të pandehurit në këtë rast akuzohen për veprën penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile, e kryer në bashkëkryerje, sipas Nenit 22 të KP të RFSJ-së. Neni thotë:

Nëse disa persona kryejnë bashkërisht një akt kriminal duke marrë pjesë në aktin e kryerjes apo në një mënyrë tjetër, secili nga ata duhet të dënohet për këtë veprë.

Nga leximi i drejtpërdrejtë i nenit, duket qartë se nuk ka rëndësi se në çfarë mënyre merr pjesë një person në kryerjen e veprës penale. Si në çdo veprë penale, elementi i dashjes, *mens rea*, duhet të jetë prezent për të provuar përgjegjësinë penale (Neni 11 i KP të RFSJ-së), por çfarë nuk mund të lexohet nga neni është se çfarë lloj veprimi dhe dashjeje e personave pjesëmarrës duhet provuar, për të përcaktuar përgjegjësinë penale për veprat penale të kryera në bashkë kryerje.

36. Përgjegjësia penale e bashkëkryerësve, që veprojnë si pjesë e një grupi të armatosur në një konflikt të armatosur, është zhvilluar në jurisprudencën ndërkombëtare, kryesisht nga TKNJ-ja. Ajo është përshkruar si koncepti i sipërmarrjes së përbashkët kriminale. Pjesëmarrja në sipërmarrjen e përbashkët kriminale si një formë e përgjegjësisë, apo teoria e qëllimit të përbashkët, siç është quajtur nga Dhoma, u vendos në Aktgjykimin në Apel në lëndën *Tadić*³, kur Dhoma gjeti se kjo ishte përcaktuar në mënyrë të nënkuptuar në Statutin e TKNJ-së, dhe ekzistonte në të drejtën ndërkombëtare zakonore në kohën e fakteve:

220. Si përfundim, Dhoma e Apelit mban qëndrimin se nocioni i projektit të përbashkët si një formë e përgjegjësisë bashkëpunuese është përcaktuar fuqimisht nga e drejta ndërkombëtare zakonore dhe po kështu është pohuar, ndonëse në mënyrë të tërthortë, në Statutin e Tribunalit Ndërkombëtar. [...].

226. Dhoma e Apelit konsideron se konsistenca dhe forca bindëse e praktikës gjyqësore dhe traktatet e referuara më lart, si dhe harmonia e tyre me parimet e përgjithshme mbi përgjegjësinë penale të përcaktuara si në Statut, ashtu dhe në të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare penale, dhe në legjislacionin vendor, përforcojnë konkluzionin që praktika gjyqësore reflekton rregullat zakonore të së drejtës ndërkombëtare.

37. Aktgjykimi në shkallën e Apelit në lëndën *Tadić* përcakton tre kategori të rasteve në lidhje me sipërmarrjen e përbashkët kriminale,⁴ ku e para ka të bëjë me rastin në fjalë:

196. Kategoria e tillë e parë përfaqësohet nga rastet ku të gjithë të bashkë-akuzuarit, duke vepruar sipas një projekti të përbashkët, zotërojnë dashjen kriminale të njëjtë; për shembull, formulimi nga bashkëkryerësit i një plani për të vrarë, ku, për të realizuar këtë projekt të përbashkët (dhe megjithëse secili bashkëkryerës kryen rol të ndryshëm në të), prapëseprapë ata të gjithë e zotërojnë dashjen për të vrarë. Kriteret objektive dhe subjektive për ta ngarkuar me përgjegjësi penale një pjesëmarrës i cili nuk e ka kryer ose nuk mund të provohet se e ka kryer vrasjen, janë si në vijim: (i) i akuzuari duhet të marrë pjesë në mënyrë vullnetare në një aspekt të projektit të përbashkët (për shembull, duke shkaktuar dhunë jo fatale mbi viktimën, apo duke dhënë ndihmë materiale apo duke lehtësuar aktivitetet e bashkëkryerësve të tij); dhe (ii) i akuzuari, edhe nëse ai vetë personalisht nuk e ka kryer vrasjen, prapëseprapë duhet ta ketë dëshiruar këtë rezultat.

38. Aktgjykimi i njëjtë pastaj përcakton elementët përbërës të *actus reus* dhe *mens rea* të kësaj forme të përgjegjësisë. Dhoma e Apelit përcakton se *actus reus* përbëhet nga këto tre elemente:

³ TKNJ, Lënda nr. IT-94-1-A, aktgjykimi i datës 15 korrik 1999.

⁴ Për një përmbledhje të të tre kategorive shiko *Krnojelac*, Aktgjykimi i Apelit të datës 17 shtator 2003, TKNJ Lënda nr. IT-97-25-A, paragrafi 30.

- (i) *Numri i shumtë i personave.* Ato nuk lypset të jenë të organizuar në një strukturë ushtarake, politike apo administrative, siç tregohet në mënyrë të qartë nga lëndët *Essen Lynching* dhe *Kurt Goebell*.
- (ii) *Ekzistenca e një plani, projekti apo qëllimi të përbashkët që përbën apo përfshin kryerjen e një krimi të parashikuar në Statut.* Nuk ka nevojë që ky plan, projekt apo qëllim të jetë rregulluar apo formuluar më parë. Plani apo qëllimi i përbashkët mund të materializohet në mënyrë të papërgatitur dhe të nxirret si përfundim nga fakti që numri i madh i personave vepron si një trup për të vënë në zbatim një sipërmarrje të përbashkët kriminale.
- (iii) *Pjesëmarrja e të akuzuarit në një projektin e përbashkët që përfshin kryerjen e një prej krimeve të parapara në Statut.* Kjo pjesëmarrje nuk ka nevojë të përfshijë kryerjen e një krimi specifik sipas njërës nga këto dispozita (për shembull, vrasje, shfarosje, torturë, përdhunim etj.), por mund të marrë formën e ndihmës apo të kontributit në ekzekutimin e planit apo qëllimit të përbashkët.⁵

Sa i përket *mens rea*-s, Dhoma e Apelit vlerësoi për këtë kategori se ajo çka kërkohet është dashja për të kryer një krim të caktuar (që është dashja e përbashkët e të gjithë bashkëkryerësve të veprës⁶

39. Gjykata e Apelit gjen se kjo formë e përgjegjesisë penale është e zbatueshme në juridiksionin e Kosovës për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile. Siç është referuar nga ana e TN-së për ish-Jugosllavinë, kjo është një formë e përgjegjesisë penale e përcaktuar në të drejtën penale ndërkombëtare dhe një interpretim i tillë mund të nxirret nga neni 22 i KPRSFJ-së (Neni 31 i KPRK-së).

40. Në lëndën tonë, Gjykata e Apelit ka gjetur të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se sulmi ndaj shtëpisë së familjes **B** u ekzekutua nga një grup i UÇK-së. Nga veprimet e grupit, vetë sulmi dhe ajo çka ndodhi pas sulmit, mund të nxirret si përfundim se synimi ose qëllimi i përbashkët i grupit ishte t'i bënte fshatarët serbë të lëshojnë shtëpitë e tyre. **E.K** dhe **S.B** ishin të dy anëtarë të UÇK-së. Menjëherë pas sulmit ata ishin të pranishëm në vendin e sulmit bashkë me ushtarë të tjerë të UÇK-së. Ata ishin të veshur me uniforma dhe mbanin pushkë. Argumenti shtesë se **E.K** u vërtetua se ishte i pranishëm edhe para sulmit, nuk është vendimtar. Situata faktike tashmë e përcaktuar nga Kolegji i Gjykatës Themelore do të mjaftonte për përfundimet e Gjykatës së Apelit. Gjykata e Apelit gjen se shpjegimet se dy të pandehurit ishin kalimtarë të rastit, thjesht duke qëndruar krahas bashkëluftëtarëve të tyre të UÇK-së, duke mos ndarë vullnetin e përbashkët të grupit, janë të paarsyeshme dhe jo logjike. I vetmi përfundim që mund të nxirret nga provat është se **E.K** dhe **S.B** dhanë kontributin e tyre në veprimet e grupit të UÇK-së që ndërmori sulmin mbi shtëpinë e **B** dhe më vonë hynë në oborrin e shtëpisë. Për rrjedhojë, përfundimi i vetëm që mund të nxirret është se edhe ata e kishin dashjen për të realizuar qëllimin e përbashkët për ta larguar popullatën serbe nga fshati.

⁵ Aktgjykimi i Apelit në rastin *Tadic*, par. 227.

⁶ Po aty, paragrafi 228.

41. Për pasojë, Gjykata e Apelit gjen se është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se **E.K** dhe **S.B** kanë kryer veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile, siç është përshkruar në Aktakuzë.

3.1.4. Caktimi i dënimit

42. **E.K** dhe **S.B** janë gjetur fajtorë për shkelje të neneve 22 dhe 142 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme nga nenet 31 dhe 153 të KPRK-së. Bazuar në parimin e zbatimit të ligjit më të favorshëm, neni 3 i KPRK-së (Neni 4, paragrafi 2 i KPRSFJ-së), gjykata së pari duhet të përcaktojë se cili ligj është më i favorshëm për të pandehurit në këtë lëndë.

43. KPRSFJ kishte dënime për Krime të Luftës kundër Popullatës Civile që përfshinin dënimin me vdekje dhe dënime me burgim prej pesë (5) dhe pesëmbëdhjetë (15) vjetësh⁷. Mirëpo dënimi maksimal prej njëzet (20) vjetësh burgim mund të shqiptohet për veprat penale që plotësojnë kushtet për dënimin me vdekje.⁸ Dënimi me vdekje u hoq më 12 dhjetor 1999⁹, pa ndonjë zëvendësim. Më 27 tetor 2000, dënimi me vdekje u zëvendësua me dyzet (40) vjet burgim.¹⁰ Bazuar në këtë, në periudhën nga 12 dhjetori 1999 deri në 27 tetor 2000, dënimi për Krime të Luftës kundër Popullatës Civile ishte burgimi nga pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet, meqë asnjë vepër nuk i plotësonte kushtet e dënimit me vdekje.

44. Dënimi në këtë lëndë sipas KPRK-së do të ishte burgim prej jo më pak se dhjetë (10) vjetësh, ose burgim i përjetshëm.¹¹

45. Parimi i ligjit më të favorshëm do të thotë se gjykata duhet të zbatojë ligjin më të favorshëm për të pandehurin, që ka qenë në fuqi në çfarëdo kohe ndërmjet kohës së kryerjes së veprës penale dhe kohës kur shqiptohet dënimi. Prandaj në këtë lëndë ligji më i favorshëm ishte ai i periudhës 12 dhjetor 1999 deri në 27 tetor 2000, me dënim me burgim ndërmjet pesë (5) dhe pesëmbëdhjetë (15) vjetësh.

46. Kur vendos për dënimin, gjykata duhet, sipas nenit 41 të KPRSFJ-së, të vlerësojë rrethanat renduese dhe lehtësuese. Mirëpo, në këtë lëndë Gjykata e Apelit duhet të vlerësojë edhe sa më poshtë.

47. Në shqyrtimin e parë gjyqësor, **E.K** u gjet fajtor për veprën penale dhe u dënua me pesë (5) vjet burgim nga Trupi Gjyqësor i Gjykatës së Qarkut të Prizrenit. Kundër aktgjykimit u parashtrua ankesë nga Prokurori Special. Mirëpo ankesa u deklarua e papranueshme nga Gjykata Supreme, prandaj, për shkak të parimit *reformatio in peius*, Gjykata e Apelit është e kufizuar nga Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prizrenit dhe nuk mund të shqiptojë dënim më të rëndë se pesë (5) vjet burgim, që gjithashtu është dënimi minimal i përcaktuar me ligj. E vetmja rrethanë lehtësuese është periudha e gjatë kohore që ka kaluar që nga kryerja e veprës penale. Më tutje,

⁷ Neni 142 KPRSFJ; minimumi 5 vjet apo dënim me vdekje, neni 38 (1) KPRSFJ, burgimi maksimal prej 15 vjetësh.

⁸ Neni 38 (2) KPRSFJ.

⁹ Rregullorja 1999/24 e UNMIK-ut, neni 1 (5).

¹⁰ Rregullorja e 2000/59 e UNMIK-ut, neni 1 (6).

¹¹ Neni 153 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.2 të KPRK-së.

nuk ka rrethana të jashtëzakonshme lehtësuese, siç parashihet në nenin 41 paragrafi 2 të KPRSFJ-së, që do ta lejonte Gjykatën e Apelit të shkonte nën minimumin e dënimit të paraparë me ligj. Prandaj, **E.K** dënohet me pesë (5) vjet burgim.

48. Për **S.B** nuk ka kufizim të sipërm si në rastin e **E.K**. Mirëpo, Gjykata e Apelit konkludon se nuk do të ishte e drejtë të zbatohet një nivel i ndryshëm i fajësisë për **S.B** dhe për **E.K**. Gjithashtu, nuk ka rrethana më lehtësuese apo më rënduese se në rastin e **E.K**. Parimi i proporcionalitetit duhet të diktojë dënimin, prandaj edhe **S.B** dënohet me (5) vjet burgim.

49. Sipas Nenit 50 paragrafët 1 dhe 3 të KPRSFJ-së, koha e qëndrimit në paraburgim përfshihet në dënimin me burg.

50. **E.K** ka qenë në paraburgim nga data 14 dhjetor 2010 deri kur u lirua më 20 gusht 2011. Kjo periudhe do të zbritet nga dënimi i tij me burgim prej (5) vjetësh.

51. **S.B** ka qenë në paraburgim nga 18 prilli 2012 deri kur u lirua më 1 shkurt 2013. Kjo periudhe do te zbritet nga dënimi me burgim prej (5) vjetësh.

3.2. Lënda e të akuzuarve M.H.1, M.H.2, N.H, N.B dhe J.K

3.2.1. Gjendja faktike

52. Trupi Gjykues i Gjykatës Themelore ka gjetur të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se **M.H.1, M.H.2, N.H, N.B** dhe **J.K**, kur u intervistuan si dëshmitarë, të gjithë u dhanë hetuesve deklarata të rrejshme lidhur datën kur u plagos **E.K**, me qëllim që të sigurohej alibia për **E.K**.

53. Gjykata e Apelit pajtohet në tërësi me vlerësimin e Trupit Gjykues. **M.H.1, M.H.2, N.H, N.B** dhe **J.K** të gjithë deklaruan – megjithëse të gjithë ishin të pasigurt për datën e saktë – se **E.K** u plagos para sulmit më 17 dhe 18 korrik 1998. Ata të gjithë dhanë arsyet se përse u kujtohej koha e plagosjes së **E.K**. Bazuar në arsyet e dhëna, siç u elaborua hollësisht nga Trupi Gjykues, Gjykata e Apelit gjithashtu gjen se nuk ka gjasa që atyre t’ju kujtohej koha e saktë.

54. Bazuar në deklaratën e Doktor **A.H**, e dhënë para hetuesve më 21 dhjetor 2010, që Gjykata e Apelit e gjen më të besueshme se deklarata e dhënë para Gjykatës më 30 qershor 2011, dhe dëshmia në formën e regjistrit, e dhënë para hetuesve nga i njëjti, Gjykata e Apelit gjen se ka gjasë më të madhe që **E.K** u plagos në gusht 1998. Duke e gjetur tashmë të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se **E.K** ishte në _____ duke marrë pjesë në sulm, Gjykata e Apelit gjen gjithashtu të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se deklaratat e **M.H.1, M.H.2, N.H, N.B** dhe **J.K** ishin të rrejshme.

3.2.2. Vlerësimi ligjor i gjendjes faktike

55. Trupi Gjykues i Gjykatës Themelore i liruar nga akuza të pesë të pandehurit me arsyetimin se, për shkak se **E.K** u lirua nga vepra penale me të cilën u ngarkua, nuk kishte bazë ligjore për t'i gjetur të pandehurit fajtorë për Dhënien e Ndhmës pas Kryerjes së Veprave Penale.

56. Gjykata e Apelit tani e ka gjetur **E.K** fajtor për Krime të Luftës kundër Popullatës Civile. Atëherë shtrohet pyetja nëse janë plotësuar elementet e tjera të veprës penale të listuara në nenin 305 të KPK-së. Paragrafët përkatës janë si në vijim:

- (1) Kushdo që strehon kryerësin e veprës penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare ose e ndihmon atë në shmangien e zbulimit të veprës përmes fshehjes së mjeteve, provave a në çfarëdo mënyre tjetër, ose kushdo që strehon personin e dënuar apo ndërmerr veprime për pengimin e ekzekutimit të dënimit a urdhrin për trajtim të detyrueshëm dënohet me burgim deri në një vit.
- (2) Kushdo që ndihmon kryerësin e veprës penale për të cilën është paraparë dënim me burgim mbi pesë vjet dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

57. Çështja ligjore në pyetje është kuptimi i fjalëve *shmangie e zbulimit*. Kur zbulohet kryesi i veprës? Gjykata e Apelit mban qëndrimin se zbulimi duhet të interpretohet si diçka që do të thotë zbulim i kryesit të vërtetë të krimit. Kryesi i vërtetë i krimit nuk gjendet deri kur ai apo ajo shpallet fajtor nga gjykata. Gjykata e Apelit gjen se neni 305 i KPK-së duhet të shihet si një dispozitë e përgjithshme që mbulon ato raste kur një person jep deklarata të rrejshme për të mbrojtur kryesin e veprës, që nuk mbulohen nga ndonjë dispozitë tjetër ligjore, si neni 307 i KPK-së që rregullon deklaratat e rrejshme në procedura gjyqësore. Kur interpretohet dispozita ligjore që nuk ka formulim të qartë, ne duhet të konsiderojmë racionalitetin e ligjvënësit, *ratio legis*. Gjykata e Apelit gjen se do të ishte kundër *ratio legis* të lejoheshin deklarata të rrejshme gjatë hetimeve. *Ratio legis* dhe statusi i përgjithshëm i nenit 305 mbështetet më tej me faktin se në bazë të Nenit 164 paragrafi 2 të të KPPK-së, dëshmitari duhet gjithmonë të paralajmërohet para dhënies së deklaratës së tij se dhënia e deklaratës së rrejshme përbën vepër penale. Kjo nuk ka kufizime në faza të ndryshme të procedurës. Në fazën e hetimeve akti i dhënies së deklaratës së rrejshme mbulohet me nenin 305 të KPK-së si rregull i përgjithshëm dhe në fazën e procedurës gjyqësore, ai mbulohet me nenin 307 të KPK-së si dispozitë e përgjithshme e kufizuar për procedurën gjyqësore.

58. **E.K** është gjetur fajtor për veprën penale me të cilën u ngarkua. Nëse nuk do të ishte gjetur fajtor, ai nuk mund të konsiderohej si kryes i veprës penale dhe kështu nuk do të ishte zbuluar si kryes i veprës penale. Kur u dhanë hetuesve deklarata të rrejshme, **M.H.1**, **M.H.2**, **N.H**, **N.B** dhe **J.K** e ndihmuan **E.K** të shmangte zbulimin, apo të shmangte gjetjen e tij si kryes i vërteti i veprës penale.

59. Gjykata e Apelit e gjen të qartë se **M.H.1**, **M.H.2**, **N.H**, **N.B** dhe **J.K** ishin të ndërgjegjshëm që nuk po u tregonin të vërtetën hetuesve dhe pavarësisht nga motivet e tyre për këtë, ata e bënë këtë për të mbrojtur **E.K**. Në këtë mënyrë, Gjykata e Apelit e gjen të provur përtej dyshimit të arsyeshëm se edhe e kishin dashjen, *mens rea*-n, për ta kryer veprën penale.

3.2.3. Caktimi i dënimit

60. Ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale ishte KPK.¹² Për shkak se Kodi i ri Penal hyri në fuqi më 1 janar 2013, KPRK, edhe për këta të pandehur Gjykata e Apelit duhet të përcaktojë ligjin më të favorshëm.

61. Dhënia e ndihmës kryerësve të veprës penale pas kryerjes së veprës penale aktualisht penalizohet nga neni 388 i KPRK-së. Për këtë vepër penale nuk ka pasur asnjë ndryshim në dënime. Mirëpo, ka pasur ndryshim në përshkrimin e veprës penale. Neni 388 (1) i KPRK-së lexon si në vijim:

- (1) Kushdo që strehon kryesin e ndonjë vepre penale, përveç veprave penale të parapara në paragrafin 2. të këtij neni, ose e ndihmon atë në shmangien e zbulimit ose arrestimit përmes fshehjes së mjeteve, provave apo në ndonjë mënyrë tjetër [...].

62. Ligjvënësi ka shtuar në KPRK fjalët “shmangie e zbulimit *apo arrestim*”. Ky është i vetmi ndryshim në substancë. Gjykata e Apelit gjen se ky ndryshim nuk e ndryshon interpretimin e vetë dispozitës. Dispozita duhet të shihet ende si dispozitë e përgjithshme dhe shmangie e zbulimit do të thotë të mos të konstatohesh si kryes i vërtetë i veprës penale d.m.th. të mos shpallej fajtor për një vepër penale. Prandaj Gjykata e Apelit gjen se asnjë ligj nuk është më i favorshëm në këtë lëndë, dhe, kështu, ligji i zbatueshëm është ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, d.m.th. KPK.

63. Meqë vepra e Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile dënohet me burgim prej më shumë se pesë vjet, dënimi për dhënie të ndihmës kryesit të veprës penale është burgim prej gjashtë (6) muajsh deri në pesë (5) vjet, sipas nenit 305 (2) të KPK-së.

64. **M.H.1, M.H.2, N.H, N.B** dhe **J.K** u gjetën fajtorë edhe në shqyrtimin e parë gjyqësor dhe nga Gjykata e Qarkut në Prizren u dënuan me gjashtë (6) muaj burgim, i kthyer me kusht për një (1) vit, sipas neneve 43-44 të KPK-së. Ashtu si në rastin e **E.K** nga ana e Prokurorit nuk u paraqit ankesë e pranueshme. Për shkak të parimit *reformatio in peius*, dënimi maksimal që mund të shqiptojë Gjykata e Apelit është (6) gjashtë muaj burgim, kthyer në dënim me kusht për një vit. Gjashtë (6) muaj burgim është edhe dënimi minimal, dhe edhe në rastin e këtyre të akuzuarve nuk ka ndonjë rrethanë të veçantë lehtësuese të kërkuar nga neni 66, paragrafi 2 i KPK-së, që do të lejonte të shkohej nën minimumin e paraparë me ligj.

65. Prandaj, **M.H.1, M.H.2, N.H, N.B** dhe **J.K**, sipas nenit 305 (2) të KPK-së, dënohen me gjashtë (6) muaj burgim, i kthyer në dënim me kusht për një periudhë prej një (1) viti, sipas nenit 41 paragrafi 1, pika 1, dhe nenit 43 paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së.

¹² Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (UNMIK/REG/2003/25) në fuqi nga 06.04.2004 deri në 31.12.2012.

3.3. Shpenzimet e procedurës penale

66. Sipas nenit 102 (1) të KPPK-së, gjykata vendos që personi i gjetur fajtor duhet të paguajë shpenzimet e procedurës penale. Gjykata e Apelit gjen se **E.K, S.B, M.H.1, M.H.2, N.H, N.B** dhe **J.K** do të mbulojnë shpenzimet e procedurës penale. Kjo zbatohet edhe në procedurat e Gjykatës së Apelit, sipas nenit 105 të KPPK-së.

67. Meqë të gjithë të pandehurit të shpallur fajtorë duhet të paguajnë shpenzimet e procedurës penale kundër tyre, ata do ta bëjnë këtë bashkërisht dhe individualisht, sipas nenit 102 (3) të KPPK-së, sepse shpenzimet konkrete për secilin prej tyre nuk mund të përcaktohen më saktë. Megjithatë, shpenzimet përkatëse të kapjes dhe shoqërimit gjatë procedurave gjyqësore duhet të mbulohen nga vetë **E.K** dhe **S.B**.

68. Gjykata e Apelit nuk e gjeti të nevojshme të mbajë seancë, sipas nenit 412 të KPPK-së, sepse Gjykata gjeti se nuk kishte pasur vërtetim të gabuar të gjendjes faktike. Më tutje, Gjykata e Apelit gjeti se, meqenëse faktet materiale ishin përcaktuar në mënyre korrekte nga Trupi Gjyqësor i Gjykatës Themelore, por duke pasur parasysh vërtetimin e gjendjes faktike, duhej të ishte marrë një aktgjykim i ndryshëm. Prandaj, Gjykata e Apelit gjen se ka baza për ta modifikuar Aktgjykimin e kundërshtuar, sipas neneve 424 dhe 426, paragrafi 1 të KPPK-së.

Kryetare e Trupit Gjyqësor

Hajnalka Veronika Karpati
Gjyqtare e EULEX-it

Anëtar i kolegjit

Timo Vuojolahti
Gjyqtar i EULEX-it
(Me mendim mospajtues)

Anëtar i kolegjit

Rasim Rasimi
Gjyqtar

Procesmbajtëse

Anna Malmström
Zyrtare Ligjore e EULEX-it

Mendimi i ndarë i Timo Vuojolahtit është bashkangjitur.

MJET LIGJOR: Në bazë të nenit 430 paragrafi 1 nën-paragrafi 3 dhe paragrafi 2 të KPPK-së, personi i autorizuar mund të paraqesë ankesë kundër këtij Aktgjykimi brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e shërbimit të kopjes së këtij Aktgjykimi.

Përgatitur në anglishte, gjuhë e autorizuar. Aktgjykim i arsyetuar u përfundua dhe u nënshkrua më 3 mars 2014.

Lënda PAKR 271/13

MENDIM PJESËRISHT I NDARË I GJYQTARIT TIMO VUOJOLAHTI

Nuk pajtohem me shumicën sa i përket akuzave kundër të pandehurve **M.H.1**, **M.H.2**, **N.H**, **N.B** dhe **J.K**.

Formulimi i pyetjes

Konsideroj se faktet relevante janë ashtu siç i ka paraqitur shumica në aktgjykim. Vetëm dua të shtoj se masa e paraburgimit është shqiptuar ndaj **E.K** më 14 dhjetor 2010. Prandaj, është dëshmuar se këta pesë të pandehur qëllimisht kanë dhënë dëshmi të rrejshme gjatë fazës së procedurës paraprake duke e mbështetur alibinë e **E.K**, përkatësisht kur janë dëgjuar në cilësi të dëshmitarit si nga hetuesit e EULEX-it ashtu edhe nga prokurori në muajin shkurt ose mars të vitit 2011 të gjithë deklaruan rrejshëm se **E.K** ishte plagosur në fillim të korrikut 1998. Përfundimi i vetëm logjik pse e kanë bërë këtë është se kanë dashur ta mbështesin alibinë e rrejshme të **E.K** sipas të cilës ai nuk ishte në fshatin më 17-18 korrik 1998 sepse ishte plagosur në betejë më 11 korrik 1998 dhe kishte qëndruar 15 ditë në spital.

Prokurori i ka akuzuar këta pesë të pandehur për vepër penale Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale, sipas nenit 305 paragrafit 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK – ligji i fuqi para datës 1.1.2013). Prandaj, bëj pyetje, a e mbulon edhe këtë situatë penalizimi nga neni 305 i KPK-së; pra dhënien e deklaratës së rrejshme para policit hetues apo prokurorit në fazën e procedurës paraprake.

Ligji

Titulli i nenit 305 të KPK-së është 'Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale'. Paragrafi i parë i nenit thotë:

Kushdo që strehon kryerësin e veprës penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare ose e ndihmon atë në shmangien e zbulimit të veprës përmes fshehjes së mjeteve, provave a në çfarëdo mënyre tjetër, ose kushdo që strehon personin e dënuar apo ndërmer veprime për pengimin e ekzekutimit të dënimit a urdhrit për trajtim të detyrueshëm dënohet me burgim deri në një vit.

Paragrafët 2 dhe 3 përcaktojnë dënim më të rëndë nëse vepra penale të pyetje është e dënueshme me dënim të caktuar maksimal me burgim.

Neni 307 (Deklarimet e rrejtshme) paragrafi 1 i KPK-së thotë:

Dëshmitari, eksperti në cilësi të dëshmitarit, përkthyesi apo interpreti i cili në procedurën gjyqësore, në procedurën për kundërvajtje, në procedurën administrative, në procedurën para noterit publik ose në procedurën disiplinore jep deklaratë të rreme dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

Përveç kësaj, neni 306 i KPK-së ka të bëjë me lajmërimet e rrejtshme dhe këto veprime i penalizon si lajmërim të pavërtetë që lajmëron se një person i caktuar ka kryer vepër penale ose se një vepër penale është kryer.

Neni 7 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore thotë:

1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim, që në momentin kur është kryer nuk përbënte vepër penale, sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.

2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara.

Neni 33 paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës thotë:

Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit.

Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore ka zbatim të drejtpërdrejtë në Kosovë, në përputhje me nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Nullum crimen, nulla poena sine lege

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) në disa raste ka theksuar se garancitë nga neni 7 duhet të shpjegohen dhe të zbatohen, sipas objektit dhe qëllimit, në mënyrë që të sigurohet mbrojtje e efektshme kundër ndjekjes penale, dënimit dhe ndëshkimit arbitrar. Neni 7 § 1 i Konventës përcakton parimin se vetëm ligji mund ta

definojë një krim dhe ta përcaktojë dënimin (nullum crimen, nulla poena sine lege). Prandaj veprat penale dhe dënimet përkatëse duhet patjetër të definohen me ligj. Ky kusht plotësohet ku individ mund ta dijë nga formulimi i dispozitës përkatëse dhe, nëse është nevoja, me ndihmën e interpretimit të gjykatës se cilat veprime ose mosveprime e bëjnë përgjegjës penalisht. (shih p.sh. lëndët S.W. *kundër*. Mbretërisë së Bashkuar dhe C.R. *kundër*. Mbretërisë së Bashkuar, 22.11.1995; Camilleri *kundër*. Maltës 22.01.2013)

Siç ka konsideruar GjEDNj-ja, si rrjedhojë e parimit se ligjet duhet të kenë zbatim të përgjithshëm, formulimet e dispozitave nuk janë gjithmonë të sakta. Kjo do të thotë se gjithmonë do të ketë nevojë për interpretim të ligjit penal (shih p.sh. Camilleri *kundër*. Maltës 22.01.2013). Megjithatë, me sa e kuptoj nuk ekziston asnjë dyshim për këtë, ligji penal nuk guxon të interpretohet gjerësisht sipas analogjisë në dëm të të akuzuarit.

Vlerësimi

Në këtë rast më duhet të interpretoj se çfarë është “dashja e vërtetë” nga neni 305 paragrafi 1 i KPK-së – pa e shkelur sigurinë në zbatimin e ligjit. Çështja kryesore është përmbajtja e këtyre dy pjesëve të dispozitës: ‘strehon’ dhe ‘ndihmon’ në shmangien e zbulimit....a në çfarëdo mënyre tjetër’.

Interpretimi i drejtpërdrejtë i fjalës “strehon”, si pikënisje, i referohet akteve konkrete si fshehja e kryerësit apo strehimi i tij. Duke pasur parasysh gjithashtu edhe mënyrën e dytë për kryerjen e veprës (actus reus), dhënie e ndihmës për të shmangur zbulimin, jep arsye për të konstatuar se strehimi, në kuptimin e kësaj dispozite është diçka që patjetër duhet të ndodhë para se kryerësi të kapet nga autoritetet. Prandaj, e gjej të pamundur që të përfshijë “dhënien e deklaratës së rreme” në kuptimin e drejtpërdrejtë të strehimit.

Pjesa e dytë e dispozitës është pjesa më problematike; ‘e ndihmon atë që t’i shmanget zbulimit... a në çfarëdo mënyre tjetër’.

Së pari, më duhet të theksoj se si i interpretoj elementet e këtij krimi (Dhënie e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprës penale). Akt i ndaluar nuk është vetëm ‘*dhënie e ndihmës kryerësit*’ në çfarëdo mënyre, sjella e ndaluar e veprës (aktit) është e kufizuar në situatat kur ndihma është dhënë me qëllim që të ndihmohet kryerësi që t’i shmanget zbulimit. Ky kufizim është bërë nga ligjvënësi dhe më duhet të vë theks të veçantë në faktin se ligjvënësi ka përdorur fjalën ‘zbulim’, dhe vetëm këtë fjalë (jo për shembull dënimin).

Së dyti, më duhet të interpretoj domethënien e zbulimit. Kuptimi i zakonshëm i fjalës zbulim mund të përkufizohet si akt i gjetjes apo diçka e panjohur më parë. Prandaj, interpretimi i drejtpërdrejtë i *“dhënie e ndihmës kryerësit për t’iu shmangur zbulimit”* lidhet me fshehjen apo mbulimin e identitetit të kryerësit në mënyrë që të mos vërtetohet identiteti i kryerësit. Për më tepër, interpretimi i drejtpërdrejtë gjithashtu mund të përfshijë situatat kur ndihma e dhënë është drejtuar për të ndihmuar kryerësin që mos të kapet, identiteti i të cilit tanimë është i njohur.

Gjatë kontrollit nëse KPK-ja ka përdorur fjalën ‘zbulim’ në mënyrë më të zgjeruar në kuptimin juridik, së pari i referohem nenit 304 të KPK-së (Moslajmërimi i veprave penale apo moslajmërimi i kryerësit të saj). Paragrafi 1 përcakton: *Kushdo që duke qenë në dijeni për identitetin e kryerësit të veprës penale... ose për kryerjen e veprës së tillë penale, nuk lajmëron faktin e tillë edhe pse zbulimi i kryerësit të veprës penale varet nga ky lajmërim...*

Në këtë dispozitë ‘zbulim’ si duket gjithashtu i referohet kryesisht gjetjes dhe kapjes së kryerësit.

Në nenin 109 paragrafin 6 të KPK-së termi ‘përkrahje e grupit terrorist’ përkufizohet në kuptim për shembull si pengimi i zbulimit dhe i kapjes së grupit terrorist ose e anëtarëve të tij. Gjithashtu në nenin 251 (Dhënia e pa arsytueshme e dhuratave) paragrafi 3 i KPK-së thuhet se nëse kryerësi lajmëron veprën para se të jetë zbuluar apo para se ai të jetë njoftuar se është zbuluar, gjykata mund ta lirojë nga dënimi.

Këto dispozita tregojnë se ligjvënësi ka përdorur fjalën zbulim apo zbulimi në KPK në të njëjtin kuptim siç është përkrahur më lart në interpretimin e drejtpërdrejtë. Për më tepër, gjithashtu duhet vërejtur se mundësimi i arratisjes së personit të privuar nga liria në mënyrë të ligjshme është e dënueshme në mënyrë të ndarë sipas nenit 314 paragrafit 1 të KPK-së. Prandaj, përfundimi im është se interpretimi i drejtpërdrejtë si dhe juridik i kuptimit të fjalës *zbulim* siç është përdorur në nenin 305 paragrafin 1 të KPK-së e bën të arsyeshme të konsiderohet se akti i cili ndihmon kryerësin që t’i shmanget zbulimit kufizohet në situatat kur kryerësi nuk është zbuluar ende; kjo do të thotë kur identiteti i kryerësit nuk është vërtetuar apo kur kryerësi akoma nuk është gjetur apo kapur.

Pas arritjes në këtë përfundimi kam gjetur se dhënia e deklaratës së rreme si dëshmitar gjatë dëgjimit në polici apo prokurori gjatë fazës së procedurës paraprake pasi që kryerësi të jetë zbuluar mund të mos mbulohet nga dispozita e nenit 305 paragrafi 1. Zgjerimi i interpretimit në mënyrë që kjo situatë të përfshihet brenda përkufizimit *“dhënie ndihmës kryerësit për t’iu shmangur zbulimit”* do të thoshte të shkohej përtej formulimit të ligjit në dëm të pandehurit dhe kështu në shkelje të parimit në nenin 7 të KEDNJ-së.

Në këtë rast kryerësi **E.K** tanimë ka qenë i zbuluar dhe i ishte caktuar masa e paraburgimit kur marrja në pyetje e **M.H.1**, **M.H.2**, **N.H**, **N.B** dhe **J.K**, kishte përfunduar .

Për më tepër, unë do ta jap vlerësimin tim se cili ka qenë qëllimi i ligjvënësit dhe çfarë ka pasur për qëllim të përmbush kjo dispozitë dhe si është implementuar ky qëllim.

Neni 164 paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-ja, kodi i vjetër i procedurës) përcakton:

Dëshmitarit së pari i tërhiqet vërejtja se detyrohet të flasë të vërtetën... pastaj i bëhet me dije se dhënia e dëshmisë së rreme është vepër penale.

Sipas nenit 237 paragrafi 1 i KPPK-së , dispozita e nenit 164 do të jetë e zbatueshme përshtatshmërisht gjatë dëgjimit të dëshmitarit para Prokurorit Publik, mirëpo betimi nuk do të kërkohet në këtë situatë.

Në njërën anë është e qartë se asnjë sistem ligjor nuk duhet ta pranojë gënjeshtren kur një person dëgjohet si dëshmitar. Nenet 164 dhe 237 të KPPK-së japin arsye të besohet se ligjvënësi nuk e pranon, si pikënisje, dhënien e deklaratës së rreme në asnjë fazë të procedurës penale. Në anën tjetër, dashja dhe qëllimi i ligjvënësit nuk mund t'i plotësoj zbrazëtitrat kur individit nuk mund ta dijë nga formulimi i dispozitës përkatëse dhe nga praktika ligjore se cilat akte do ta bëjnë penalisht përgjegjës. Është përgjegjësi e ligjvënësit që të kaloj ligje penale në atë mënyrë që kushtet e përcaktuara me nenin 7 të KEDNJ-së të jenë përmbushur – gjykata nuk mund ta plotësojë një zbrazëtitrë të qartë në ligjin penal.

Sa i përket deklaratës së rreme, ligjvënësi në mënyrë të qartë ka përcaktuar në nenin 307 se dhënia e dëshmisë së rreme në cilësinë e dëshmitarit në procedurën gjyqësore i nënshtrohet dënimit. Në krahasim me këtë dispozitë neni 305 paragrafi 1 i KPK-së, sepse për shkak të përmbajtjes së përgjithshme dhe të paqartë të dispozitës, ngitet çështja, se a mundet kjo dispozita e fundit në cilindo rast të interpretohet se e përfshinë deklaratën e rreme të dhënë në procedurë penale, edhe pse kryerësi i vërtetë ende mund të jetë i pazbuluar.

Siç është theksuar tanimë, unë konsideroj se dhënia e dëshmisë së rreme gjatë dëgjimit në cilësinë e dëshmitarit në fazën e procedurës paraprake dhe pasi që kryerësi i veprës penale nën hetime të jetë zbuluar nuk i nënshtrohet dënimit sipas dispozitave të KPK-së. Duke pasur parasysh faktet e lëndës siç janë përshkruar më lart, unë i liroj nga akuza të pandehurit **M.H.1**, **M.H.2**, **N.H**, **N.B** dhe **J.K**.

TV

